

# DEFOKUSIM I FOKUSIT

Kryerje formale e detyrave apo demokratizim  
përmes Marrëveshjes së qershorit/korrikut?



European  
Policy  
Institute.  
Skopje

Shkurt 2016, Shkup

***Publikues:***

Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

***Për publikuesin:***

D-r Malinka Ristevska Jordanova

***Autorë:***

D-r Malinka Ristevska Jordanova

D-r Simonida Kacarska

M-r Aleksandar Jovanoski

M-r (në Shkencat Juridike) Ardita Abazi Imeri

Leposava Ognjanoska

***Disenji:*** Gaia Design

Vetëm version elektronik në dispozicion

---

Zbatimi i Marrëveshjes (Marrëveshja e Përzahinos) qershor / korrik gjendet në një fazë kritike.<sup>1</sup>

Më 18 janar, Kuvendi pranoi dorëheqjen e ish kryeministrit Gruevski dhe votoi Qeverinë e re. Ky hap u mirëprit si një pjesë e rëndësishme e zbatimit të Marrëveshjes së Përzahinos. Megjithatë, dorëheqja u lidh me vendimin e Kuvendit për shpërbërjen e tij - me zbatim të shtyrë (më 24 shkurt), në kundërshtim me praktikën parlamentare deri tani. Qëndrimi zyrtar<sup>2</sup> i partisë kryesore të opozitës është se ajo nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme nëse nuk ndryshon data e mbajtjes së tyre, duke marrë parasysh vonesën serioze në zbatimin e reformave të kërkuara.

**Nga monitorimi sistematik i Rrjetit 23<sup>3</sup> të zbatimit të Marrëveshjes të Përzahinos është arritur përfundimi se Marrëveshja po zbatohet me vonesa të konsiderueshme dhe në mënyrë selektive, në një klimë fort të polarizuar politike. Parimet dhe synimet e Marrëveshjes janë lënë pas dore; fokusi është vendosur mbi përgatitjen e nxituar të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në datën e përcaktuar me Marrëveshjen. Për më tepër, prioritetet për reforma urgjente nuk janë zbatuar në esencë<sup>4</sup>**

Kundërshtimi ndaj zbatimit të Marrëveshjes është i fuqishëm. Në fjalimin e tij më 24 janar të vitit 2016 ish-kryeministri sulmoi në mënyrë të drejtpërdrejtë bartësit e roleve vendimtare në zbatimin e Marrëveshjes së Përzahinos, veçanërisht Prokurorinë Publike Speciale dhe ndërmjetësuesin e BE-së.<sup>5</sup>

<sup>1</sup> Marrëveshja e Përzahinos, apo Marrëveshja e qershorit/korrikut, paraqet një marrëveshje e firmosur nga liderët e katër partive politike të Maqedonisë, që janë primare për zgjidhjen e krizës politike, me mbështetje ndërkombëtare. Raporti i KE i vitit 2015 përshkruan krizën me formulimin vijues: *Sivjet Republika e Maqedonisë është përballur me krizën më të vështirë politike që nga viti 2001. Kultura përçarëse politike, mungesa e kompromisit dhe dobësia e dialogut mori formën e krizës së vazhdueshme dhe të zvarritur politike, duke përfshirë këtu bojkotimin e Kuvendit nga partia kryesore opozitare dhe pakësimin e besimit në institucionet publike. Kriza është thelluar edhe më tepër me publikimin e bisedave të përgjuara, ku janë përfshirë funksionarë të lartë qeveritar dhe të partisë në pushtet, dhe ku janë sugjeruar shkelje të të drejtave bazë, ndërhyrje në pavarësinë gjyqësore, në lirinë e mediave dhe në zgjedhjet, si dhe politizim dhe korrupsion në fusha të ndryshme.*

<sup>2</sup> <http://www.sdsm.org.mk/default.aspx?mld=55&agId=6&articleId=13469>

<sup>3</sup> Rrjeti 23 paraqet një rrjet nga 11 organizata të shoqërisë civile të Maqedonisë, të cilat monitorojnë, vlerësojnë dhe hulumtojnë çështjet lidhur me Kapitullin 23 të Dokumentit Para-aderues të BE-së; gjyqësori dhe të drejtat bazë. Më tepër informacione në: [www.merc.org.mk](http://www.merc.org.mk)

<sup>4</sup> Memorandumet e Rrjetit 23 mbi Politikën lidhur me zbatimin e prioritetëve të reformave urgjente Zbatimi i prioritetëve për reforma urgjente është më i ngadalshëm sesa rivendosja e praktikave kundër-reformiste dhe zbatimi i Marrëveshjes Politike të qershorit/gushtit "Fjala është Fjalë": Si po zbatohet Marrëveshja e Përzahinos?, si dhe udhëzimet mbi monitorimin, të cilat mund të gjenden në: <http://www.epi.org.mk/newsDetail.php?nwsid=89>.

Të dhënat e vizualizuara mbi zbatimin e prioritetëve të reformave urgjente dhe azhurnimet ditore, mund të gjenden në: <http://www.merc.org.mk/en/status-on-the-implementation-of-the-urgent-reform-priorities>.

Të dhënat e vizualizuara dhe korniza kohore e zbatimit të Marrëveshjes së qershorit/korrikut, të azhuruara në bazë ditore, mund të gjenden në: <http://www.merc.org.mk/en/level-of-realization-of-the-june-july-political-agreement>.

<sup>5</sup> Përkthimi jozyrtar i fjalimit mund të gjendet në:

[https://www.dropbox.com/sh/f0by3yua5bb2z9w/AAB7f5ZrV88MBqAa\\_MiovcVla?dl=0](https://www.dropbox.com/sh/f0by3yua5bb2z9w/AAB7f5ZrV88MBqAa_MiovcVla?dl=0)

## PËRQËNDRIMI I FOKUSIT

Çështja kryesore që është imponuar në rendin e ditës është nëse janë të mundshme zgjedhje të besueshme, të lira dhe të ndershme të parakohshme parlamentare më 24 prill 2016, siç parashikohet në Marrëveshjen.

Ambasadorët e SHBA-së dhe BE-së, Baily dhe Orav, më 29 janar 2016 i dërguan letër Kryeministrit të sapoemëruar, Emill Dimitriev, në të cilën vendosen standarde si bazë për vlerësimin që do të lëshohet nga BE-ja dhe SHBA-të, nëse janë plotësuar kushtet për të zbatuar zgjedhje të besueshme.<sup>6</sup>

Ky raport, jep një analizë të nivelit të zbatimit të secilës pikë të referimit, duke u bazuar në monitorimin tonë. Data e fundit është 17 shkurt 2016. Konstatohet se rregullime në çastin e fundit janë të mundshme, ashtu si ka qenë dhe korniza e zbatimit të Marrëveshjes deri më tani. Megjithatë, këto zgjidhje në çastin e fundit tregojnë vetëm nivelin e nxitimit dhe improvizimit në një proces që është me rëndësi vendimtare për qytetarët e vendit.

### Zgjedhjet

**Në përputhje me Marrëveshjen politike, përbërja e Komisionit Shtetëror Zgjedhor duhet të rishikohet dhe të modifikohet. Kjo gjë u realizua më 15 dhjetor të vitit 2015, me vonesë nga 135 ditë. Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor më 9 nëntor të vitit 2015, KSHZ-së iu dhanë kompetenca të zgjeruara për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme, si dhe kushte të barabarta për të gjitha partitë politike dhe kompetenca të fuqishme të mbikëqyrjes. Ky aktivitet u realizua me vonesë nga 40 ditë.**

*Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) duhet të ketë personelin dhe fondet e plota.*

Kohët e fundit institucionet përkatëse shtetërore i kanë dhënë mbështetje KSHZ-së sa i përket personelit dhe financimit. Megjithatë, mungon zbatimi praktik. Më 26 janar, KSHZ shpalli një thirrje të hapur për punësimin e dhjetë punonjësve.<sup>8</sup> Stafi (i planifikuar për TI dhe sektorin juridik), ende nuk është rekrutuar, pasi procedurat sipas ligjeve në fuqi janë të ndërlikuara.<sup>9</sup> Edhe sikur këto procedura të finalizoheshin së shpejti, mbetet problematike mënyra se si personeli i angazhuar së fundi mund të merret me përgjegjësitë komplekse të KSHZ-së në lidhje me listën e zgjedhësve sipas Ligjit dhe metodologjive të reja. I vetmi fuqizim i kapaciteteve deri më tani janë ekspertët e angazhuar për të mbështetur KSHZ-në (5) të punësuar me ndihmën e projekteve të huaja. Fondet në dispozicion në kuadër të buxhetit të KSHZ-së aktualisht mund të shpenzohen vetëm nga dita e zgjedhjeve e më tej; ende nuk janë dakorduar modalitetet për disponueshmërinë e fondeve për zbatimin e metodologjive të miratuara.

*Sa i përket listës zgjedhore, për të dhënë një ide të qartë për përmasat e procesit të pastrimit, duhet të jetë kryer një kontroll i kryqëzuar fillestar i të gjitha bazave të të dhënave relevante, duke përfshirë*

<sup>6</sup> Mund të gjendet në: [goo.gl/5x1bKz](http://goo.gl/5x1bKz)

<sup>7</sup> Komunikatë për Media, Ministria e Financave, <http://www.finance.gov.mk/mk/node/5560>

<sup>8</sup> Thirrja e hapur mund të gjendet në: [http://www.sec.mk/images/oglas1\\_2016.png](http://www.sec.mk/images/oglas1_2016.png). Në kuptimin e afatit të fundit për seleksionim, thirrja e hapur i referohet Nenit 23 (2) të Ligjit të Punës, i cili parasheh se perioda minimale është 45 ditë pas skadimit të afatit për dërgimin e aplikimeve.

<sup>9</sup> Veç kësaj, mungesa e miratimit të Metodologjisë për Përfaqësim të Drejtë ka penguar këto procedura. Sipas disa burimeve, Metodologjia para ca kohe është aprovuar, por ende nuk është publikuar zyrtarisht.

Metodologjitë për pastrimin e listës zgjedhore janë miratuar më 3 shkurt të vitit 2016, me **52 ditë** vonesë, duke shkelur dispozitën përkatëse të Kodit Zgjedhor.<sup>10</sup> KSHZ-ja publikoi një thirrje të hapur për kompanitë / individët për të kryer kontroll të kryqëzuar me një afat të pabesueshëm prej tri ditësh për të dorëzuar aplikimet (5 shkurt 2016),<sup>11</sup> ku u zgjodhën pesë ofertues. Më 12 shkurt 2016 KSHZ mori bazat e të dhënave të kërkuara, por nevojitej kohë plotësuese për t'i siguruar ato në formatin e duhur. Nuk ka informacione nëse kanë filluar kontrollet e kryqëzuara. Mungojnë rezultatet fillestare të kontrolleve; për rrjedhojë në këtë moment nuk jepet një ide për përmasat e procesit të pastrimit.

*Duhet të përcaktohet një program i besueshëm, që parasheh kohë dhe financa të mjaftueshme për të hetuar dhe për të vendosur rreth anomalive të gjetura gjatë kontrollit.*

Deri më tani nuk ka program të tillë të publikuar. Në dy ditët e mbetura (nga afati përfundimtar që është caktuar në letrën e ambasadorëve), është e pamundur të finalizohet kontrolli i kryqëzuar, për të analizuar tërësisht rezultatet e saj dhe për të vendosur masa për të hetuar dhe për të vendosur rreth anomalive.

Sipas metodologjive të miratuara, Komisioni Shtetëror Zgjedhor duhet të publikojë listën zgjedhore 10 ditë pas vendimit për zgjedhje të parakohshme (e cila do të jetë 6 mars). Deri atëherë kontrollet në terren, (edhe pse kanë të bëjnë vetëm me të dhëna të caktuara, jo për gjithë listën zgjedhore) duhet të përfundojnë. Metodologjitë përfshijnë procedura të sakta për anketime në terren, një fushatë publike dhe veprime të tjera. Kjo është një përpjekje e pamundur në tre javë e gjysmë që kanë mbetur deri më 6 mars, në qoftë se mbetet të vlejë data e 24 prillit.

*Duhet të vendoset një kornizë e qartë ligjore për largimin në kohë të emrave që nuk i përkasin listës zgjedhore, dhe të krijohen mekanizmat e përshtatshëm për shënimin e emrave që nuk mund të hiqen, por të cilat kërkojnë shqyrtim shtesë. Duhet siguruar një mekanizëm të fuqishëm dhe të drejtë për trajtimin e ankesave gjatë procesit të pastrimit të listës zgjedhore duke ftuar OSBE-në që të monitorojë procedurat.*

Deri tani nuk është vendosur kornizë ligjore. Asnjë anëtarë i stafit nuk është rekrutuar, edhe pse procedura është në vazhdim e sipër.

**Si përfundim, kriteret që lidhen me zgjedhjet nuk janë zbatuar. Nuk ka absolutisht asnjë dëshmi të paraqitur se lista zgjedhore do të përditësohet në kohë për të siguruar zgjedhje të besueshme më 24 prill. Ndodh e kundërta, i gjithë procesi është shndërruar në zbatim të nxituar të metodologjive, pas bisedimeve mes partive, duke rezultuar në një operacion thjeshtë formal të plotësimit të detyrave. Kjo është në kundërshtim me qëllimin e Marrëveshjes së Përzhinos dhe cenon besueshmërinë e zgjedhjeve.**

<sup>10</sup> Sipas Nenit 80 të Kodit Zgjedhor, metodologjitë duhej të miratoheshin brenda 30 ditëve pas hyrjes në fuqi të Kodit.

<sup>11</sup> <http://www.sec.mk/files/javen-povik-za-izbor-na-IT-kompanii.pdf>

## Mediat

*Afati për marrëveshje mbi reformat në lirinë e mediave ishte fundi i gushtit. Marrëveshja ende nuk është arritur. **Vonesa është 169 ditë.***

Pavarësisht ngeçjes së konstatuar në Raportin e KE-së në lidhje me lirinë e shprehjes dhe mediave,<sup>12</sup>, kjo temë arriti si e fundit në agjendën e bisedimeve ndërpartiake. Për shkak të bllokimit të negociatave lidhur me mediat, ndërmjetësi ndërkombëtar Peter Vanhoutte në dhjetor të vitit 2015 paraqiti një propozim të mbështetur fuqishëm nga BE-ja dhe SHBA-të që ende përforcon pjesërisht diskutimet mbi këtë çështje. Sipas mediave, LSDM ka mbështetur këtë propozim.<sup>13</sup> VMRO-DPMNE nuk e mbështet propozimin, duke shprehur megjithatë gatishmërinë për të pranuar një ligj të cilitdo shteti anëtar të BE-së.

*Transmetuesit televizivë duhet të demonstrojnë përputhshmërinë me kërkesat ligjore në bazë të nenit 61 të Ligjit mbi Shërbimet Audio dhe Audio-Vizuale për të siguruar "prezantim objektiv dhe të paanshëm të ngjarjeve, me trajtimin e barabartë të pikëpamjeve dhe opinioneve të ndryshme", si dhe me ligjet e tjera që kërkojnë qasje të drejtë në media.*

Monitorimi ekspert i mediave ka treguar se pesë kanalet televizive pro-qeveritare (TVM1, MTV2, Sitel, Kanal 5 dhe Alfa) në punën e tyre "kanë tendencë për të përhapur kryesisht qëndrimet e strukturave politike në pushtet, duke mos siguruar hapësirë për qëndrimet dhe mendimet e opozitës apo haptas i sulmojnë dhe satanizojnë ato.<sup>15</sup> Për më tepër, transmetuesit publik "vazhdimisht janë në shërbim të strukturave në pushtet njësoj si disa nga transmetuesit televiziv komercial". Kjo është konfirmuar nga dy raundet mujore të monitorimit të medias në dhjetor dhe janar.

Pati vetëm një ndryshim të theksuar në raportimin e transmetuesve më të mëdhenj kombëtarë, Sitel dhe Kanal 5. Domethënë, ndryshe nga vitet e kaluara (deri në 8), ata ftuan përfaqësues të opozitës për intervista gjatë lajmeve kryesore. Megjithatë qëllimi natyrisht ka qenë përmirësimi i imazhit të këtyre mediave në radhë të parë përpara opinionit të huaj, këto hapa nuk kanë paraqitur një ndryshim të vërtetë në politikën redaktuese, por edhe më tepër kanë konfirmuar kontrollin e shtetit mbi to.<sup>16</sup>

Në këtë drejtim, intervista e kryeredaktorit të TV Sitel, ishte një shembull i qasjes së njëanshme.<sup>17</sup> Gjatë intervistës, kryeredaktori i Sitel-it paraqiti listing të komunikimeve të ndjekura në Viber dhe telefona celularë, që pati për qëllim shikuesve t'u tregojë se përgjimi i komunikimeve ende po vazhdonte. Këto intervista ilustruan thellësinë e problemit në lidhje me përfaqësimin në media dhe zhdukuri iluzionin për një zgjidhje të shpejtë.

<sup>12</sup> [Rekomandimi nën hije: Analiza e Komisionit Evropian, Raporti i Progresit të Republikës së Magedonisë i vitit 2014](http://epi.org.mk/docs/Overshadowed%20recommendation%20-%20commentary%20PR%202014%20en.pdf), mund të gjendet në: <http://epi.org.mk/docs/Overshadowed%20recommendation%20-%20commentary%20PR%202014%20en.pdf>

<sup>13</sup> Negociatat mbi mediat sot, 2 shkurt, viti 2016, Vest <http://www.vest.mk/?ItemID=F4345EA3949DDD4DB5E08D6147C8E926>

<sup>14</sup> <http://vmro-dpmne.org.mk/?p=29354>

<sup>15</sup> Raporti i Dytë i Monitorimit të Mediave, Instituti i Studimeve të Komunikimit, shkurt, viti 2016 [http://republika.edu.mk/modem/19-29-januari/Second-Monthly-report-MODEM\\_mk\\_opt.pdf](http://republika.edu.mk/modem/19-29-januari/Second-Monthly-report-MODEM_mk_opt.pdf)

<sup>16</sup> Kryeredaktorja e Kanal5 në intervistën e saj me liderin e opozitës, Zoran Zaev, kishte thënë se ajo ishte urdhëruar për të bërë një intervistë me të. Mund të gjendet në: <https://youtu.be/FOkTmXzOe34>

<sup>17</sup> Intervista me Zoran Zaev në TV Sitel, 10 shkurt, viti 2016: <https://youtu.be/Y9XHmqizqBI>

Zhvillimi i fundit në këtë drejtim është një hap prapa ku VMRO DPMNE i referohet Kodit Zgjedhor, i cili sipas tyre rregullon të gjitha aspektet e përfaqësimit në media në lidhje me administrimin e zgjedhjeve.<sup>18</sup> Nga ana tjetër, për LSDM-në, reformat e mediave janë një "sine qua non" për mbajtjen e zgjedhjeve.<sup>19</sup>

Në këtë pikëpamje, nuk duhet harruar se mediat (duke përfshirë gazetaret, shoqatat dhe pronarët e tyre) janë aktorët kryesorë që kanë kërkesat e tyre legjitime që duhet të përfshihen me këtë proces.

***Këto kritere nuk janë zbatuar fare. Edhe në qoftë se ndryshime të caktuara ligjore do të miratohen së shpejti, zbatimi i tyre do të jetë i pamundur në kornizën kohore të caktuar.***

## **Ndarja e shtetit nga partia**

*Duhet të merren masa për të siguruar ndarje të mjaftueshme në mes të aktiviteteve shtetërore dhe partiake dhe për të sanksionuar shpërdorimet.*

Kryeministri i ri, Emill Dimitriev, i emëruar me propozim të VMRO-DPMNE-së më 18 janar, në deklaratën e tij para Parlamentit gjatë shpalesjes së Programit<sup>20</sup> ka deklaruar qartë se krahas sigurimit të zgjedhjeve të ndershme, qeveria do të vazhdojë të punojë edhe në zbatimin e projekteve nga programi i saj. Kjo është në mënyrë eksplicite në kundërshtim me marrëveshjen qershor / korrik, në të cilën thuhet se "programi i Qeverisë do të kufizohet në organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare". Në praktikë, zbatimi i programit politik të Qeverisë VMRO-DPMNE dhe BDI mbetet prioritet.

*Zyrtarët e lartë duhet të japin deklaratë të qarta dhe udhëzime me shkrim se nuk do të tolerohet asnjë presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe se asnjë punonjës apo qytetar nuk duhet të frikësohet se do të humb vendin e punës ose shërbimet sociale si rezultat i mbështetjes ose mosmbështetjes së ndonjë partie politike.*

Deri më tani, nuk ka asnjë dëshmi se udhëzimet e tilla janë lëshuar. Edhe sikur të jenë lëshuar, këto udhëzime nuk do të mbizotëronin mesazhet politike nga udhëheqësit e partive, siç ishte fjalimi i ish-kryeministrit, i mbajtur më 24 janar.

Për më tepër, hulumtimet tona të fundit, duke përfshirë një studim që konfirmon se qëndrimi mbizotërues i punonjësve të sektorit publik është se anëtarësimi partiak vjen para sistemit të meritës.<sup>21</sup> Ata bëjnë thirrje për departizimin e institucioneve. Punësimi në baza partiake shkakton një problem ende më të madh. Vërehet një trend punësimesh pa bërë vlerësimin paraprak të nevojave dhe profilit të të punësuarve. Punonjësit bëjnë thirrje për zbatimin e plotë të sistemit të meritës duke respektuar parimet e kompetencës dhe integritetit.<sup>22</sup>

<sup>18</sup> Konferenca për Shtyp e VMRO-DPMNE-së, 1 shkurt, viti 2016, mund të gjendet në: <http://vmro-dpmne.org.mk/?p=29354>

<sup>19</sup> Konferenca për Shtyp e LSDM-së, 1 dhjetor, viti 2015, mund të gjendet në: <http://sds.org.mk/News.aspx?idNews=88&lng=1>

<sup>20</sup> Raporti Tekstual nga seanca plenare e 88 e Asamblesë, 18 janar, viti 2015. Mund të gjendet në: <http://sobranie.mk/sessiondetails.nsp?sessionDetailsId=5f7f6f8c-c29e-4ec9-b951-c0d4f58b259d>

<sup>21</sup> IPE "Përfaqësimi i drejtë etnik në administratën shtetërore" – Analiza e gjetjeve të anketës së zbatuar me 400 nëpunës administrativ dhe intervistat me nëpunësit në pozita drejtuese nga pushteti qendror dhe lokal, qershor-dhjetor, viti 2015

<sup>22</sup> Punonjësit në sektorin publik për vendosjen e mekanizmave për tejkalimin e manipulimeve politike të ligjeve, sidomos në pjesën që ka të bëjë me procedurën e rekrutimit, zbatimin e qëndrueshëm të metodologjisë së planifikimit të punësimeve, të cilat, sipas tyre, duhet ta përmirësojnë transparencën e procedurave të punësimit të punonjësve administrativ.

*Pretendimet e besueshme për presione dhe frikësime duhet të hetohen mënyrë urgjente dhe të detajuar (dhe atëherë kur do të jetë e përshtatshme), autorët të ndiqen penalisht nga autoritetet relevante.*

Më 12 shkurt, Prokuroria Publike Speciale (PPS) ka informuar opinionin publik për rastin e tyre të hetimit të hapur, ku përfshihen krime lidhur me zgjedhjet.<sup>23</sup> PPS kërkoi arrestim për ish Ministren e Punëve të Brendshme, të ish Ministrit të Transportit dhe Komunikimeve, Sekretarit të Përgjithshëm të Qeverisë, dhe 5 personave tjerë. Megjithatë, gjykatësi i procedurës para-gjyqëse kishte sjellë vendimin kundër propozimit të PPS, gjë kjo që është në kundërshtim me praktikën e deritanishme.<sup>24</sup> Përderisa shoqëria civile vazhdimisht ka përfaqësuar dhe ka mirëpritur qasje të re (dhe përfundimisht më shtrënguese) të arrestimit, shqetësimet për një drejtësi selektive sipas vendimeve të përmendura më lartë po fuqizohen dhe më tepër.<sup>25</sup>

Pengimi i punës së Prokurorisë Publike Speciale është intensifikuar. Deri më tani, janë ngritur 19 padi penale kundër anëtarëve të ekipit të Janevës për shpërdorim në kryerjen e detyrës – lloj i rastit që asnjëherë më parë nuk është parë në vend.<sup>26</sup> Aq më tepër, Këshilli i Prokurorëve Publik vazhdimisht ka kërkuar raporte dhe sqarime nga PPS, kurse Kryetari i Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë kishte reaguar për lajmërimin e PPS-së se gjykatat administrative kanë qenë nën hetim, duke e kualifikuar atë si “presion mbi gjykatësit”.<sup>27</sup>

***Nuk janë zbatuar pikat e referimit për ndarjen e shtetit nga partia. Përkundrazi, ka indikacione se vazhdon kontrolli i partisë mbi institucionet shtetërore.***

<sup>23</sup> Shoqërimi kriminel, sipas Nenit 394 të Kodit penal; Shkelja e së drejtës së votimit (Neni 159); Shkelja e së drejtës së zgjedhjes së lirë të votuesit (Neni 160); Mitëmarrja gjatë zgjedhjeve dhe votimit (Neni 162); Shkatërrimi i materialeve zgjedhore (Neni 164) dhe Abuzimi i mjeteve financiare të fushatës zgjedhore (Neni 165-a).

<sup>24</sup> Në raportin e fundit të bërë publik të Prokurorisë Publike, është theksuar kërkimi i arrestimit për 278 raste, gjykata ka aprovuar arrestim për 275 raste dhe burg shtëpiak në tre rastet tjera. Mund të gjendet në: <http://tinyurl.com/hduvyk5>

<sup>25</sup> Deri në përfundimin e këtij raporti, Këshilli Penal i Gjykatës Penale të Shkupit ende nuk ka shqiptuar Vendimin e vet për ankesat e PPS-së për vendimet e mosshqiptimit të arrestimit.

<sup>26</sup> Konferenca për Shtyp e Prokurorisë Publike Speciale, 12 shkurt, viti 2016

<sup>27</sup> Hetimet e sapo hapura nga Prokuroria Publike Speciale për arsye të dyshimit të arsyetuar për krime kundër zgjedhjeve, pretendohet se përfshijnë pesë gjykatës nga kjo Gjykatë, për Shpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit, sipas Nenit 353 të Kodit Penal. Deklarata e Kryetarit të Këshillit Gjyqësor mund të gjendet në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/288/133032190>



## KONKLuzionet dhe Rekomandimet

- **“Pikat ndërmjetëse të referimit” për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare ende nuk janë zbatuar.**
  - Nuk ekzistojnë dëshmi të besueshme se lista zgjedhore është pastruar me kohë.
  - Reformat e mediave ende nuk kanë filluar. Përkundrazi, mbetet kontrolli shtetëror mbi mediat.
  - Nuk ekzistojnë dëshmi që do të tregojnë se procesi i ndarjes së shtetit nga partia po zbatohet. Pengimet e zbatimit të Marrëveshjes, e sidomos të veprimeve të Prokurorisë Publike Speciale tregojnë pikërisht të kundërtën.
- **Procesi i vlerësimit të zbatimit të Marrëveshjes së qershorit/korrikut është shndërruar në një operacion të kryerjes formale të detyrave. Dhënia e vlerësimit pozitiv lidhur me gatishmërinë për zgjedhje në këtë çast jo vetëm që nuk do ta legjitimizojë pengimin e Marrëveshjes, por gjithashtu do të nxis konflikt të brendshëm dhe përçarje në të gjitha nivelet. Fokusi aktual mbi datën e zgjedhjeve u kundërvihet parimeve dhe qëllimeve të Marrëveshjes së qershorit/korrikut.**
- **Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes së Përzahinos duhet të bëhet në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke marrë në konsideratë parimet dhe qëllimet e saj. .**
- **Оценката на спроведувањето на Договорот од Пржино треба да биде сеопфатна и да ги земе предвид неговите начела и цели.**
- **Shoqëria civile duhet në mënyrë më sistematike të përfshihet në shqyrtimin e krizës, si dhe në procesin e vlerësimit të zbatimit të Marrëveshjes.**
- **Shqyrtimi i krizës në Maqedoni duhet të rifokusohet drejt rrënjëve të saja, të diagnostifikuara me Raportin e Priebe-së dhe të rekomandohen prioritetet e reformave urgjente:**
  - Liria e mediave,
  - Pavarësia e gjyqësorit dhe luftimi i nivelit të lartë të korrupsionit,
  - Gjyqësori funksional dhe kontrolli parlamentar i përgjimit të komunikimeve;
  - Përgjimi, kontrolli dhe organet rregullatorë,
  - Depolitizimi i administratës publike
- **Nëse duhet ruajtur Marrëveshjen e Përzahinos:**
  - Qeveria e periudhës së tranzicionit duhet të veprojë në mënyrë efektive dhe vetëm në drejtim të organizimit të zgjedhjeve të lira dhe të drejta,
- **Duhet parandaluar/sanksionuar pengimet e mëtejshme të zbatimit të Marrëveshjes.т.**